



TRIBUNA

REVISTË MUJORE MBI TRANSPARENCËN DHE LLOGARIDHËNIEN NË
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE TË KOSOVËS

PRILL, 2017

SINDIKALE

- **Raporti I
përgjithshëm I
Protestës nga
FSSHK**

- **Raporti I
përgjithshëm I
Grevës nga
FSSHK**

- **Raportet nga
ana e Zyreve
Regjionale të
FSSHK-së**

**Protesta Paralajmëruese më 29.03.2017 dhe
Greva e Përgjithshme më 27.04.2017 organizuar nga FSSHK**



**Fotot të realizuara gjatë Protestës Paralajmëruese 29.03.2017 dhe
Grevës së Përgjithshme 27.04.2017**

Raport i përgjithshëm i Protestës Paralajmëruese të mbajtur me datë 29.03.2017

Me datë 29.03.2017 duke filluar nga ora 08:00-09:00 Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me të gjitha Sindikatat e saj ka mbajtur Protestë paralajmëruese para hapësirave të institucioneve shëndetësore të Republikës së Kosovës.

FSSHK duke u bazuar në Ligjin për tubime publike si dhe Ligjin mbi Organizimin Sindikal ka bërë njoftimin pranë organeve të rendit si dhe pranë Drejtorive të institucioneve shëndetësore, gjithashtu FSSHK ka njoftuar edhe Kryeinspektorin e Punës për mbajtjen e Protestës por edhe të gjitha mediat vendore ato qendrore dhe lokale.

Në bazë të informimit nga terreni Protesta paralajmëruese ka filluar ashtu siç është paraparë në ora 08:00 në të gjitha institucionet shëndetësore në nivel vendi, protestës i janë përgjigjur shumica dërmuese e punëtorëve shëndetësor të cilët kanë qenë në punë në momentin e mbajtjes së Protestës, të gjitha shërbimet emergjentë kanë dhënë shërbim dhe nuk ka pasur ngecje në ofrimin e shërbimeve shëndetësore ndaj pacientëve.

Sa i përket përkrahjes së Protestës FSSHK ka pranuar letër mbështetëse nga ana e EPSU (European Public Service Union) ku FSSHK është anëtare, kjo është deklarata e tyre:

Federata Evropiane e Sindikatave të Shërbimit Publik mbështet protestën e Punëtorët shëndetësor në Kosovë.

Anëtarët tuaj si shumë punëtorë të tjerë të shërbimit publik në Evropë meritojnë rritje të pagave . Puna e infermierëve, mjekëve dhe punëtorëve të tjerë shëndetësorë në institucionet shëndetësore të Kosovës duhet të respektohet dhe të vlerësohet . Kjo është një punë e denjë e cila bëhet për të kuruar dhe për tu kujdesur për ata njerëz që janë të sëmurë, lënduar dhe kanë probleme shëndetësore. Punëdhënësit dhe qeveria duhet të ju sigurojë kushte adekuate të punës, siguri dhe shëndet në punë të gjithë punëtorëve shëndetësorë, Kjo është një luftë e përbashkët e jona ne Evropë dhe e juaja në Kosovë.

Ashtu si në shumë vende të tjera ne kemi nevojë për staf te kualifikuar në mënyrë qe të ofrojmë cilësinë e kujdesit qe ne duam për popullin. Nëpër Evropë punëtorët dhe sindikatat janë duke luftuar për kujdesin e duhur, punë cilësore dhe kushtet e duhura. Qeveria duhet të investojnë në shëndet në mënyrë qe të drejtën për kujdes shëndetësorë ta bëjë realitet.

Në emër të 8 milion anëtarëve te EPSU nga 260 Sindikata ju uroj sukses ju dhe Sindikatës në protestën e nesërme.

TRIBUNA

sindikale

“Ky botim është realizuar nga ana e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e ekskluzive e FSSHK-së.”

Pas përfundimit të Protestës Paralajmëruese të gjitha Zyrat Regjionale të cilat kanë monitoruar procesin kanë paraqitur raportin e tyre duke vënë në pah se pjesëmarrja e protestuesve ka qenë e kënaqshme dhe se nuk është regjistruar asnjë incident i cili do të ndikonte në mbarëvajtjen e Protestës dhe nuk ka pasur asnjë ndërhyrje apo reagim nga ana e menaxhmenteve të institucioneve shëndetësore, në këtë rast e organet e rendit të cilët kanë vëzhguar Protestën kanë qenë të pranishëm për mbajtjen e rendit publik.

Përgjashtimisht në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka ndodhur një rast i izoluar kur një qytetar i është drejtuar me fjalë fyese Kryetarit të Sindikatës së QKUK-së Dr. Xhemajl Selmanit, por që i njëjti nuk ka ndikuar në mbarëvajtjen e protestës.

Protesta është përcjellë nga të gjitha mediat vendore si ato të shtypit por edhe TV sikurse RTK,KTV,RTV21,Klan Kosova dhe TV lokale si TV Dukagjini, TV Syri, e të tjera, ku janë prononcuar përfaqësuesit e FSSHK-së respektivisht Kryetarët e Sindikatave duke filluar nga Kryetari i FSSHK-së i cili është intervistuar gjatë gjithë ditës së Protestës por edhe ditët para saj, pastaj për QKUK Dr. Xhemajl Selmani, Z. Sherif Makolli nga QKMF-Prishtinë, Bujar Agusholli Kryetar i Sindikatës së Spitalit në Pejë, Znj. Tevide Imeri nga Sindikata e QKMF-Ferizaj dhe të tjerët.

Nora Murataj

Zyrtare Ligjore e Z.Q. të FSSHK-së







Raporti mbi mbarëvajtjen e Grevës së përgjithshme me datë 27.04.2017

Me datë 27.04.2017 duke filluar nga ora 07:00h e mëngjesit Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka organizuar Grevë të Përgjithshme në të gjitha institucionet shëndetësore të nivelit parësor, dytësor dhe tretësor.

Greva ka filluar ashtu siç është paraparë dhe nga terreni janë marrë informacione çdo dy orë respektivisht nga ana e Zyrtarëve në Regjione janë dërguar raportet me shkrim për mbarëvajtjen e Grevës .

Grevën e përgjithshme e kanë përcjellë të gjitha mediat vendore qendrore dhe lokale, gjithashtu Kryetari i FSSHK-së është kontaktuar edhe nga mediat të huaja të cilat kanë përcjellë rrjedhën e Grevës së përgjithshme.

Nga procesi 24 orësh nuk është evidentuar asnjë incident i cili do të ndikonte në thyerjen e Grevës me përjashtim të disa rasteve të izoluara të cilat me angazhimin e Përfaqësueseve Regjional respektivisht Kryetarëve të Këshillave Grevist janë evituar.

Vlen të theksohet se Këshilli Qendror Grevist gjatë gjithë 24 orëshit të mbajtjes së Grevës ka qenë në kontakt me të gjitha Këshillat Grevist të Sindikatave ku dhe është marrë informacioni i përgjithshëm për mbarëvajtje të Grevës.

Grevën e Përgjithshme e kanë mbështetur edhe organizatat si motra nga Evropa dhe më gjerë, gjegjësisht FSSHK ka marrë përkrahje nga ana e EPSU-së dhe PSI-së.

Greva e përgjithshme në të gjitha institucionet shëndetësore përfundoi me sukses në ora 07:00 të datës 28.04.2017.

Nora Murataj

Zyrtare Ligjor e Z.Q. të FSSHK-së

RAPORT I GREVËS NGA SINDIKATA E REGJIONIT TË GJAKOVËS

Në datën 27 Prill, 2017 në të gjitha institucionet shëndetësore në Regjionin e Gjakovës, është mbajtur greva 24 orëshe e punëtorëve shëndetësorë. Duke u nisur nga gjendja aktuale në shëndetësi dhe pas Protestës së datës 29.03.2017, punëtorët shëndetësorë të Regjionit Gjakovë kanë përkrahur masivisht Grevën e datës 27.04.2017 për plotësimin e kërkesave kryesore si kthimi i Ligjit të Pagave i cili është diskriminues për punëtorët shëndetësorë, rritja e pagave dhe përmirësimi i kushteve të punës.

Paraprakisht, Zyra Regjionale e FSSHK-së Gjakovë, ka bërë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e grevës deri në zhvillimin e saj. Në çdo institucion shëndetësor greva ka filluar në orën 07:00.

Gjatë gjithë kohës, Zyra Regjionale e FSSHK-së Gjakovë ka qenë në kontakt me Kryetarët/et dhe Anëtarët/et e Këshillave Grevist të Regjionit Gjakovë, me Përfaqësuesin Regjional si dhe me Zyrën Qendrore në lidhje me raportimin mbi ecurinë e vazhdueshme të grevës në të gjithë Regjionin e Gjakovës.

Gjatë kësaj dite, Përfaqësuesi Regjional Z.Edmond Arapi ka vizituar të gjithë Sindikatat e Regjionit Gjakovë për të parë nga afër situatën gjatë mbajtjes së grevës.

Respektivisht, të gjithë Kryetarët/et e Këshillave Grevist të Sindikatave të Regjionit Gjakovë, gjatë gjithë kohës kanë raportuar me shkrim dhe nëpërmjet telefonit mbi ecurinë e grevës deri në përfundim të saj për çdo institucion shëndetësor përkatës. I njëjti raportim i është përcjellë vazhdimisht Zyrës Qendrore të FSSHK-së.

Në Sindikatën e Spitalit “Isa Grezda” Gjakovë, greva përgjithësisht ka vazhduar e qetë dhe e rregullt. Këshilli Grevist vazhdimisht ka zhvilluar vizita në Spital për të qenë më afër me zhvillimin e grevës. Ka pasur ardhje të vazhdueshme të palëve apo pacienteve, mirëpo që e kanë mirëkuptuar grevën dhe qëllimin e saj. Gjatë natës janë shënuar dy incidente të vogla mirëpo që ka arritur të zgjidhen pa ndonjë problem.

Në Sindikatën e QKMF-së Gjakovë, greva po ashtu ka vazhduar e rregullt, e qetë dhe pa ndonjë incident. Ardhje të pacientëve ka pasur mirëpo ka funksionuar vetëm Emergjencia dhe pjesa tjetër e palëve e kanë mirëkuptuar grevën. Greva në QKMF-në Gjakovë ka vazhduar e qetë dhe pa shënuar ndonjë eksces deri në përfundim të saj në orën 07:00 të datës 28.04.2017.

Në Sindikatën e QKMF-së Rahovec, greva ka vijuar sipas planifikimeve pa ndonjë shqetësim. Në Emergjencë një rast ka bërë fjalë, mirëpo që çështja është zgjidhur pa krijuar probleme. Më pas greva ka vazhduar e qetë deri në përfundim të saj.

Në Sindikatën e QKMF-së Malishevë, greva ka vazhduar normalisht pa ndonjë incident. Numri i pacientëve ka qenë përgjithësisht i vogël. Me përfundimin e ndërrimit të parë, greva ka vazhduar njëjtë e qetë dhe në ndërrimin tjetër.

Në Sindikatën e QKMP-së Gjakovë, Kryetarja e Këshillit Grevist Znj. Mirlinda Rudi ka raportuar se të gjithë punëtorët e QKMP-së Gjakovë kanë qenë në vendet e tyre të punës duke respektuar grevën. Greva ka vijuar e qetë duke mos shënuar asnjë incident.

Në Sindikatën e QSHM-së Gjakovë, greva po ashtu ka vazhduar e rregullt. Një pacient ka reaguar kundër grevës dhe ka kërkuar të ankohet për dhënie të shërbimit, mirëpo që situata është qetësuar dhe greva ka vijuar normalisht.

Të gjithë Kryetarët/et e Këshillave Grevist të Sindikatave të Regjionit Gjakovë po ashtu janë intervistuar nga televizione Lokale mbi grevën e kësaj dite.

Greva përgjithësisht në të gjithë Regjionin e Gjakovës ka qenë e qetë, e rregullt pa ndonjë eksces, përveç disa rasteve të vogla që janë përmendur më lart mirëpo që janë zgjidhur në moment pa shkaktuar ndonjë problem shqetësues.

Ne si Zyrë Regjionale, pas lajmërimit të Kryetarëve/eve të Këshillave Grevist dhe marrjes së informacioneve nga ata për gjendjen e asaj kohe, e kemi përfunduar punën në orën 21:00.

Majlinda Karaj
Zyrtare Ligjore në Z.R. Gjakovë

RAPORT I GREVËS NGA SINDIKATA E QKUK-së

Pas mbledhjes së Kryesisë së FSSHK datë:20.04.2017,u mur vendimi për mbajtjen e Grevës 24 orëshe me datë;27.04.2017 me fillim në ora 07.00h, deri me 28.04.2017 në ora 07.00.h

Këshilli Drejtues i SQKUK duke i njoftuar anëtarët me vendimin njëkohësisht me udhëzimet ,ia filluan përgatitjet dhe organizimi i Grevës në Klinikat e QKUK.

Me zgjedhjen e Këshillit Grevist i përberë nga 5 anëtarë ,u ndanë përgjegjësitë e detyrat në mënyrë të qartë e të saktë, puna në grup, komunikimi i duhur dhe monitorimi kontinuel, bëri që gjithçka të ishte nën kontrole për aq sa varej prej nesh.

Mos reflektimi i strukturave përgjegjëse të shtetit rreth kërkesave të FSSHK në protestën e mbajtur me: 29.03.2017,bëri që detyrimisht të organizohej Grevë në fjalë.

Qëllimet edhe kësaj here ishin po ato: Abrogimi i Ligjit të pagave në tërësi, dhe rritja e pagave 15%.

Prononcimi i Kryetarit të SQKUK ,Nënkryetarit të SQKUK njëkohësisht Kryetar i Këshillit Grevist ishin të tilla që në mënyrë të kurtë e njoftuan edhe opinionin mbi qëllimin dhe ecurinë e Grevës

Meqenëse QKUK ka gjithsej 33 Klinika kjo tregon se edhe brenda Klinikave ka diversitet rreth qëndrimeve ideve e përcaktimeve sindikaliste

Pikërisht flas për ato Klinika në të cilat u shënuan incidente fatmirësisht të vogla por tendencioze, rreth organizimit të Grevës nga ana e FSSHK ,edhe pse qëllimet e Grevës ishin qëllim mira, në të mirë të gjithë personelit shëndetësorë pa përjashtim klinikash!

Mbas raportimit maratone 12 orësh çdo dy orë nga Këshilli Grevist ndërmjet Zyrës së SQKUK, duke qene koherent me ngjarjen dhe zhvillimin e saj, u përmbyll cikli i parë i Grevës si proces, duke vazhduar me 12 orëshin e dyte saktësisht deri sot në orën 07.00 ku edhe përfundoi

Tani nëse objektivat do të realizohen dhe kur do të realizohen mbeten në dorë dhe vendim të mekanizmave shtetëror, e të cilën do duhej të reflektonin dhe të tregoheshin me konstruktiv se sa deri tani, për deri sa FSSHK edhe një here ju vuri në pah qëndrimet dhe këmbënguljen e punëtorëve shëndetësorë mbi të drejtat e tyre!

Zana Morina
Zyrtare Ligjore në QKUK

RAPORT MBI GREVËN NGA REGJIONI I PRIZREN-it

Greva në institucionet shëndetësore të Regjionit të Prizrenit ka kaluar qetësisht ku mbajtja e saj ka vazhduar 24 orë përkatësisht nga ora 7.00 e mëngjesit të datës 27.04.2017 deri në 7.00 të mëngjesit të datës 28.04.2017. Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar vetëm rastet emergjente për mos rrezikim të shëndetit të pacientëve.

Këshillat Grevist të Sindikatave të Regjionit të Prizrenit kanë qenë vazhdimisht në gatishmëri rreth paraqitjes së ndonjë pa rregullësie eventuale brenda institucioneve shëndetësore dhe të njejtit kanë bërë vizita të vazhdueshme në reparte të Spitalit të Prizrenit përkatësisht nëpër punkte të QKMF-ve të regjionit të Prizrenit ku është konstatuar kjo gjendje për secilin regjion të Prizrenit:

- Në Spitalin e Prizrenit përgjithësisht ka mbizotëruar një gjendje e qetë ku nuk ka pasur ndonjë pa rregullësi apo incident të evidentuar. Numri i pacientëve ka qenë dukshëm më i ulët dhe janë trajtuar vetëm rastet emergjente të cilat po ashtu kanë qenë në numër më të vogël se zakonisht.
- Në QKMF- në e Prizrenit gjithashtu Greva ka kaluar në rregull, pa incidente dhe me mirëkuptim në mes të punëtorëve shëndetësor dhe pacientëve kurse sa i përket menagjmentit në këtë qendër duhet të theksohet se ka një përjashtim sa i përket respektimit të mbajtjes së Grevës për arsye se Drejtori i QKMF-së së Prizrenit z.Mehmedali Gashi i kishte angazhuar diku rreth 15 punëtorë shëndetësor për vizita sistematike në disa shkolla me arsyetim se nuk ka mundur ti ndalë për arsye se shkollat në fjalë kanë qenë te para lajmëruara më herët për vizitat që do të bëhen. Rastet emergjente po ashtu janë marrë parasysh dhe janë trajtuar edhe në këtë qendër.
- Në QKMF-në e Suharekës po ashtu greva ka kaluar e qetë me një numër të vogël të pacientëve që kanë kërkuar ndihmë mjekësore dhe me raste urgjente shumë të pakta. Gjatë ditës këtë qendër e ka vizituar Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë z.Frashër Behluli i cili ka shpreh interesim për mbarëvajtjen dhe ecurinë e grevës. Po ashtu ka pasur vizitë edhe nga gazetarë të Theranda Pres të cilët kanë kërkuar informata rreth grevës në fjalë.
- Edhe QKMF-ja e Dragashit u harmonizua me një gjendje të qetë ku punëtorët shëndetësor kanë qenë rregullisht në vendet e tyre të punës, fluksi i pacientëve ka qenë dukshëm më i vogël kurse emergjenca e kësaj qendre ka trajtuar vetëm tri raste me dhënje të trajtimit të nevojshëm mjekësor.

Saranda Kasami

Zyrtare Ligjore e Z.R. Prizren

RAPORTI MBI GREVËN NGA REGJIONI I PRISHTINËS

Ju njoftojmë se pas komunikimit me të gjithë kryetarët e Këshillave Grevist ne Regjionin e Prishtinës edhe 12 orëshi i dytë i Grevës ka vajtur pa probleme, nuk ka pasur fluks të madh të pacientëve vetëm disa raste emergjente me përjashtim të një rasti në QKMF-Prishtinë ku një pacient ka kërcënuar mjeken e ndërrimit të natës dhe mjekja është detyruar ta ftoj policinë mirëpo në fund ka përfunduar çdo gjë mirë dhe pa hapje të ndonjë procedure.

Greva 24 orëshe përfundoi sot me datë 28.04.2017 në ora 07:00 të mëngjesit.

Ne si Regjion i Prishtinës shprehim falënderim për të gjithë qytetarët të cilët kanë pasur mirëkuptim dhe e kanë mbështetur Grevën tonë!

Mbesim me shpresë se kjo Grevë do të ketë efekt pozitiv në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës duke ofruar dialog konstruktiv dhe të dobishëm për të gjithë punëtorët shëndetësor.

Valmira Kasumaj

Zyrtare Ligjore e Z. R. Prishtinë

RAPORTI MBI GREVËN NGA REGJIONI I GJILANIT

Ju njoftoj se gjatë 24 orëve të grevës në regjionin e Gjilanit ka pasur këto zhvillime :

Spitali i Përgjithshëm në Gjilan ka trajtuar vetëm 69 raste emergjente.

QKMF-ja, në Gjilan, ka pasur afër 100 raste emergjente ndërsa shërbimet e dhënies së injeksioneve dhe kontrolleve të rregullta i ka ndërprerë.

QKMF-ja, në Kamenicë, ka pasur afër 20 raste emergjente ndërsa shërbimet e dhënies së injeksioneve dhe kontrolleve të rregullta i ka ndërprerë, përveç një rasti kur mjeku është deklaruar se jemi në grevë dhe nuk i ofrojmë shërbimin të dhënies së injeksionet ndërsa infermierja këtij qytetari ia kryer shërbimin duke mos e respektuar vendimin e mjekut.

QKMF-ja, në Viti, ka pasur afër 86 raste emergjente ndërsa shërbimet e dhënies së injeksioneve dhe kontrolleve të rregullta i ka ndërprerë.

QKMF-ja, në Novobërdë, ka pasur vetëm 1 rast emergjente ndërsa shërbimet e dhënies së injeksioneve dhe kontrolleve të rregullta i ka ndërprerë.

Të gjithë punëtorët ju kanë përgjigjur grevës në 100%, ashtu që të njëjtit kanë qëndruar në vendet e tyre të punës kryesisht nëpër dhoma të veta, të painformuar, përveç punëtorëve të emergjencave.

Vlen të theksohet numri jashtëzakonisht i vogël i pacientëve të cilët kanë kërkuar shërbime mjekësore, të cilët kanë qenë të informuar mirë për këtë grevë.

E rëndësishme është që nuk ka pasur asnjë incident në regjionin e Gjilanit.

Në përgjithësi deri më tani greva është zhvilluar në përputhje të plotë sipas udhëzimeve të FSSHK-ës.

Fadil Sinanaj– Zyrtare Ligjore e Z. R. Gjilan

RAPORT I GREVËS NGA REGJIONI I PEJËS

Greva e datës 27.04.2017 e cila filloi në ora 07:00 të mëngjesit, u mbajt në të gjitha Institucionet Shëndetësore në Regjionin e Pejës u respektua nga punëtorët , por edhe nga qytetarët të cilët shprehën mirëkuptimin e tyre duke na përkrahë në kërkesat tona.

Gjatë gjithë ditës greva ka qenë e qetë dhe pa ndonjë incident apo parregullsi, ajo vazhdoi të mbahej ashtu e qetë edhe në orët e vona të natës e deri sot në ora 07:00 të mëngjesit datë 28.04.2017.

Nga komunikimet e vazhdueshme që i kam pasur me Kryetarë të Këshillave Grevist gjatë ditës së djeshme, por edhe sot konstatojmë se GREVA në Regjionin e Pejës ka filluar dhe ka përfunduar e qetë, dhe është mbajtur në bazë të vendimeve dhe udhëzuesit për grevë.

Mbesim me dëshirën dhe shpresën që Instancat e larta Shtetërore të reflektojnë karshi interesave të Punëtorëve Shëndetësor.

Albulena Seferqaj Ademaj
Zyrtare Ligjore e Z.R. Pejë

RAPORT I GREVËS NGA REGJIONI I MITROVICËS

Ju njoftoi se në bazë të vizitave në Spitalin e përgjithshëm Mitrovicë, Spitalin e Vushtrrisë, QKMF-Vushtrri dhe QKMF-Skenderaj me Këshillat grevist të njësive përkatëse nuk ka ndonjë problem që vlen të specifikohet nga këto njësi.

Vlen të përmendet se në Spitalin e Vushtrrisë dhe QKMF-Vushtrri e kishin vizituar emergjencën dhe laboratorin inspektorati shëndetësor i cili vepron në kuadër të M.SH por të cilën nuk kanë jep shpjegim dhe janë larguar menjëherë.

Andaj mund të konstatoj se greva në të gjitha institucionet shëndetësore në regjion deri në këto qaste është duke rrjedhur normal pa asnjë problem. Gjithashtu një falënderim shkon edhe për të gjithë qytetarë të cilën kanë treguar një mirëkuptim.

Edhe në këtë raport po e theksojmë se në baze të konsultimeve me këshillat grevist në Regjion e Mitrovicës edhe në 12 orëshin e fundit d.m. th gjate natës gjendja ka kaluar e qetë dhe nuk kemi ndonjë vërejtje sa i përket mbarëvajtjes së grevës. Gjithashtu ju informojmë se në regjionin e Mitrovicës në orën 07.00 greva ka përfunduar konform vendimeve dhe udhëzuesit të këshillit qendror grevist .

Veton Fejza
Zyrtar Ligjor në Z.R. Mitrovicë

RAPORTI I GREVËS NGA REGJIONI I FERIZAJT

Edhe në Regjionin e Ferizajt Greva e përgjithshme ka filluar në ora 07:00 ku i janë përgjigjur të gjithë punëtorët shëndetësor , nga raportimet e ardhura nga Kryetarët e Këshillave Grevist është kumtuar se procesi i Grevës në tërësi ka qenë në rregull dhe nuk është evidentuar asnjë rast i cili do të ndikonte në mbarëvajtjen e Grevës , si e tillë Greva ka përfunduar me sukses të nesërmen në ora 07:00 në të gjitha institucionet shëndetësore të Regjionit të Ferizajt. Respekt i veçantë për pacientët të cilët janë solidarizuar me Grevën e Punëtorëve shëndetësor.

Nora Murataj

Zyrtare Ligjore në Z. Q. të FSSHK-së

RAPORTI I GREVËS NGA INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK

Ju njoftoj se me rastin e organizimit të Greves (njezet e kater oreshe) nga keshilli drejtues i FSSHK me daten 27/04/2017 punetoret e Institutit Kombetar te Shendetesise Publike te Kosoves i jane pergjigjur ne menyre unanime dhe kane respektuar me perpikmeri kerkesat nga udheheqesit sindikal per mos kryerjen e puneve te perditshme, respektivisht sherbi-meve shendetsore qe i kryen Instituti Kombetar i Shendetsise Publike te Kosoves.

Ju njoftoj se nga udheheqesit e Institutit, punetoret nuk kane pasur asnje presion per te kryer punet e perditshme.

Presion kemi pasur nga pacientet per te marre rezultatet e kryera paraprakisht, por edhe ketu ne pergjithesi eshte rrespektuar greva dhe kemi kaluar mire.


Raportet nga Regjionet-pjese e Institutit Kombetar te Shendetsise Publike te Kosoves - Mitrovica,Peja,Gjakova ,Prizreni ,Ferizaj dhe Gjilani, tregojne se Greva eshte mbajtur dhe rrespektuar me perpikmeri dhe pa probleme te theksuara.

Vehbi Tahiri

Kryetar I Sindikatës së IKSHPK-së

Disa foto nga Greva e përgjithshme e datës 27.04.2017







Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The trade Union Health Federation of Kosova
Sindikalna Federacija Zdravstva Kosova

Public Service International

Adresa: Rr. Musaft Kruja, V/17, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel&Fax: +381(0) 38 726-246, mob: +377(0) 45 588-902

Web: www.fsshk.eu, email: info@fsshk.eu

Ky botim është realizuar nga ana e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës FSSHK-së. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e FSSHK-së.

Na vizito- www.fsshk.eu

Redaktori përgjegjës:
 Dr. Blerim Sylja-Kryetar i FSSHK
 Bashkëpunëtoreshë profesionale
 Nora Murataj